



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1128/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Selim Rustemi kandidat për asamble kuvendit komunale nga subjekti politik Partia Demokratike e (PDK) dega në Vushtrri, paraqitur kundër komisionerëve të qendrave të vendvotimeve, për shkak të parregullsive dhe manipulimit të votave gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Selim Rustemi kandidat për kuvendin komunal në Vushtrri nga radhët e subjektit politik PDK.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Selim Rustemi anëtarë për asamble komunale nga subjekti politik PDK dega në Vushtrri, i cili pretendon se në rezultatet e publikuara nga KQZ-ja në qendrat e votimit me numër 2705B, 2712B, si dhe në vendvotimin me numër 2713B, më mungojnë një numër i konsideruar i votave dhe kërkon që qendrat e votimit në fjalë të rinumërohen.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit Selim Rustemi nga komuna e Vushtrrisë. PZAP-i, vlerësoi si të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse siç pretendon pala ankuuese andaj ankesa e tillë është e pa bazuar dhe në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartpërmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësë

Anr. 1128/2013 më datën 06.12.2013



**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (njëzetekatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.